



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**

**Thirrje për aplikim:**

**A. 1 Punonjës sezonal pranë AdZM Korçë/Parku Kombëtar i Prespës**

**Nga:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)  
Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë,  
www.turizmi.gov.al

**Kontakte:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)  
e-mail: Info@akzm.gov.al

**Date:** 25.07.2023

**Titujt vakantë:**

A. 1 Punonjës sezonal pranë AdZM Korçë/Parku Kombëtar i Prespës për 5 muaj (Gusht – 31 Dhjetor 2023).

**Referenca.:** Rezultati 1, Aktiviteti 1.4 (Pozicioni 1A)  
sipas projektit të financuar nga PONT dhe zbatuar nga AKZM

**1. Hyrje**

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë,

institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi mund të vizitoni në: [www.pont.org](http://www.pont.org).

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e tretë të tij (2023) dhe sipas planit operacional do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2023. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parku Kombëtar i Prespës në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parku Kombëtar i Prespës.

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Korçë me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

## **2. Subjekti i aplikimit**

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për Parku Kombëtar i Prespës, PONT ka dhënë një grant për AdZM Korçë, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë në AdZM Korçë.

AKZM tani fton kandidatët e kualifikuar për pozicionin e mëposhtëm të punës:

A. 1 Punonjës sezonal pranë AdZM Korçë/Parku Kombëtar i Prespës të paraqesin shprehjen e tyre të interesit dhe të dorëzojnë CV-të e tyre dhe dokumentet e tjera mbështetëse siç janë renditur më poshtë në paragrafin 3.

## **3. Kushtet për aplikim**

- Personat e interesuar duhet të japin informacionin e tyre duke demonstruar se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet sipas kërkesave të ToR-ve, përmes CV-së së tyre dhe dokumenteve të tjera mbështetëse si kopjet e diplomës; kopjet e certifikatave për kurset e trajnimit të ndjekura, studime të tjera pasuniversitare, nëse ka.
- Për pozicionin e shpallur, gjuha e CV-së duhet të jetë shqip dhe CV-ja të jetë e firmosur dhe të tregojë pozicionin për të cilin aplikon kandidati.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura duhet të jetë brenda datës 31 Korrik 2023 – ora 14.00.
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë të rregullt ose personalisht në AKZM: (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Pozicioni \_\_\_\_\_. Vëmendje Oficeri i Komunikimit, Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë) ose me e-mail në adresën: [info@akzm.gov.al](mailto:info@akzm.gov.al).
- Pozicioni për të cilin kandidati po aplikon duhet të shënohet në zarf dhe në subjektin e aplikimit me email.
- Dokumentet e marra pas afatit dhe jo sipas kërkesave të mësipërme, nuk do të merren në konsideratë dhe do të përjashtohen nga konkurrimi.

- Modeli i CV-së është i disponueshëm në Aneksin 2 të kësaj ftese (Ju lutemi referojuni: Aneksit: 1A për Termat e Referencës (ToRs) dhe Aneksit 2 për formularin e CV-së).
- Në rast të shpalljes fitues, shërbimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët.

**Me respekt,**  
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

## Annex 1A

### TERMAT E REFERENCES

#### 1A. 1 Punonjës sezonal pranë AdZM Korçë/ Parku Kombëtar i Prespës

<b>Autoriteti kontraktues:</b>	AKZM/AdZM Korçë
<b>Burimi i financimit:</b>	Prespa Ohrid Nature Trust PONT
<b>Referenca e buxhetit:</b>	Rezultati 1, Aktiviteti 1.4
<b>Detyra e ekspertit:</b>	1 Punonjës sezonal për AdZM Korçë/ Parku Kombëtar i Prespës
<b>Kohëzgjatja:</b>	5 muaj nga data e kontraktimit, përkohësisht Gusht 2023 – 31 Dhjetor 2023
<b>Input:</b>	Me kohë të plotë për 5 muaj.
<b>Tipi i kontratës:</b>	Kontratë shërbimi 5-mujore,
<b>Vendndodhja:</b>	Punonjësi do të qëndrojë në ZM në AdZM Korçë.
<b>Reporton tek:</b>	Drejtori i AdZM-së. Koordinimi i përditshëm me specialistin e menaxhimit dhe monitorimit.

#### Hyrje:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: [www.pont.org](http://www.pont.org).

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e tretë të tij (2023) dhe sipas planit operacional do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2023. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parku Kombëtar i Prespës në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parku Kombëtar i Prespës.

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Korçë me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për Parku Kombëtar i Prespës, PONT ka dhënë një grant për AdZM Korçë, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë. AKZM po mbështet punësimin e stafit, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit të sapo punësuar.

### **Objektivi i punës:**

Shtigjet zgjerohen në të gjithë territorin e parkut dhe janë të shpërndara në gjatësi dhe vështirësi të ndryshme. Fatkeqësisht, shtigjet janë të mirëmbajtura keq dhe të mbingarkuara me bimësi.

Prandaj, detyrat kryesore të punonjësit sezonal janë:

- 1) Hapja e shtigjeve dhe lirimi i tyre nga pemët dhe bimësia.
- 2) Shënim i shtigjeve me ngjyra në mënyrë që alpinistët të mund të gjejnë lehtësisht drejtimet.
- 3) Regjistrim i gjurmëve në GPS.
- 4) Pastrim i shtigjeve nga mbeturinat.
- 5) Shërbim në orjentimin e turistëve dhe guidave.
- 6) Vrojtim i vazhdueshëm për të shmangur rrezikun nga zjarri.
- 7) Asistim në fikjen e zjarrit dhe mbrojtjen e florës dhe faunës në rast rreziku.

Pagesa do të bazohet në rezultatet në fund të çdo muaji të punës, të verifikuara dhe të dokumentuara nga mbikëqyrësit.

Koordinimi i përditshëm dhe mbikëqyrja teknike bëhet me Udhëheqësit e Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të AdZM-së.

### **Përmbledhja e detyrave të një punonjësi sezonal:**

- Pastrimi i shtigjeve nga pemët e bimët dhe pengesave të tjera që pengojnë alpinistët të lëvizin lirshëm. Shtigjet duhet të pastrohen në një gjerësi dhe lartësi prej 3 metrash.
- Shënim i shtigjeve me ngjyra në mënyrë që alpinistët të gjejnë lehtësisht rrugën e tyre. Shenja duhet të vendoset në një distancë që demarkacioni i ardhshëm të mund të shihet gjithmonë në të dy drejtimet e lëvizjes në shteg. Distanca maksimale midis shenjave duhet të jetë 5 m. Duhet të përdoret demarkacioni tipik bardhë-kuq-bardhë. Në vendkalime duhet të vendosen më shumë shenja në mënyrë që të sigurohet orientimi.
- Gjurmimi i shtigjeve me GPS/Celular.
- Mledhja e mbeturinave në shtigje ose pranë tyre.
- Suport i turistëve përgjatë shtigjeve.
- Vrojtim dhe monitorim i vazhdueshëm i ZM për të shmangur rrezikun nga zjarri.
- Ndihmon në fikjen e zjarrit dhe izolimin e tij.

Sipas planit operacional vjetor të AdZM-së, punëtorit do t'i jepet një listë e detyrave të detajuara, shtigjeve të caktuara dhe plani personal mujor i punës, i cili do të miratohet nga mbikëqyrësi - Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit dhe Menaxhimit në AdZM.

**Kualifikimet:**

- Fizikisht i aftë dhe i gatshëm për punë fizike.
- I apasionuar mbas aktiviteteve në natyrë, duke marrë parasysh kushtet klimaterike.
- Aftësi praktike, p.sh. në përdorimin e furçës dhe bojës, llak me ngjyra, duke përdorur sharrë elektrike me zinxhir, sharrë, çekiç, sëpatë me lopatë etj.
- Kanë avantazh personat që jetojnë, kanë lidhje ose janë me origjinë nga Parku Kombëtar i Prespës.
- Të gatshëm për të punuar edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

**Aneksi 2 CV form**
**Pozicioni:** *Shënoni pozicionin për të cilin aplikoni*
**CURRICULUM VITAE**

- 1. Mbiemri:** xxx  
**2. Emri:** xx  
**3. Ditëlindja:** xx  
**4. Kombësia:** xx  
**5. Gjendja civile:** xx  
**6. E-mail:** xx  
**7. Celular:** xx  
**8. Edukimi:**

Data (nga – deri)	Institucioni	Diplomat:
Xxx	X	X
Xxx	X	X
Xx	X	x

**9. Aftësitë në gjuhët e huaja:** Vlerësoni nivelin nga 1 deri në 5 (5 – shkëlqyeshëm; 1 – bazë)

Gjuha	Të lexuarit	Të folurit	Të shkruarit
X	Gjuha amtare		
X			
X			
X			

**10. Anëtarësimi në grupe profesional:** / xxx

**11. Aftësi të tjera:**

**12. Pozicioni aktual:** xxx

**13. Vite në këtë pozicion:** x years

**14. Aftësi kyçe:**

- *Përshkruani në detaje*

**15. Eksperiencia specifike në rajon:**

Shteti	Data nga – deri
XXX	Muaji/Viti

### 16. Eksperienca profesionale

Data nga – deri	Vendi	Kompania	Pozicioni	Përshkrimi
xxx - aktualisht	xx	xx	x	<i>Përshkruani me detaje</i>
xxx - xxxx				•
xxx – xxxx				•
xxx – xxxxxx				•
xxx - xxx				•

### 17. Informacione të tjera:

Data	Titulli i trajnimit/workshopit	Vendi, institucioni
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	
Xxx	Xxx	
Xxx	Xxx	

### 18. Publikime:

Autori (Viti)– Titulli, Gazeta/shtëpia botuese